



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____, datë _____

PËR

DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8378, DATË 22.7.1998,
“KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR*

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 8, të nenit 2, shtohet pika 9, me këtë përmbajtje:

“9. Sinjalistika rrugore për rrugë, në afërsi të të cilave ka institucione arsimore, përcaktohet në aktet në zbatim.”.

Neni 2

Pika 12, e nenit 7, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Cilido, që nuk respekton ndalimin e qarkullimit, qarkullon në sens të kundërt me atë të lejuar, nuk zbaton detyrimin e përparësisë dhe të

* Ky ligj përfaqëson Direktivën 2014/45/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit të 3 Prill 2014 mbi kontrollin teknik periodik të automjeteve dhe rimorkiove të tyre, FZ L. 127, 29.04.2014, f. 59 dhe Rregulloren e zbatimit të Komisionit BE 2019/621 e 17 Prill 2019 mbi informacionin teknik të nevojshëm për testimin e vlefshmërisë së aftësisë në rrugë për automjetet/artikujt që do të testohen, duke përdorur metodat e rekomanduara të testimit dhe duke vendosur rregulla të detajuara në lidhje me formatin e të dhënave dhe procedurat për aksesimin në informacionin përkatës teknik, FZ L. 108, dt. 23.4.2019.

ndalimit në kryqëzim, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në dhjetë mijë lekë dhe për rastet kur qarkullon në sens të kundërt me atë të lejuar, përveç masës së mësipërme, drejtuesit të mjetit i pezullohet leja e drejtimit për një periudhë 3-mujore dhe gjithashtu hiqen pikët nga leja e drejtimit, sipas përcaktimeve të bëra në aktet në zbatim.”.

Neni 3

Pas shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 12, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) Policisë Ushtarake (IQRr), për mjetet tokësore me targa të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes.”.

Neni 4

Pas pikës 18, të nenit 41, shtohet pika 19, me këtë përmbajtje:

“19. Në aktet në zbatim përcaktohet afati kohor i dritës semaforike në të gjitha pasrastet e impianteve semaforike.”.

Neni 5

Neni 50 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 50 Mjete me pedale

1. Mjete me pedale janë mjete me dy ose me më shumë rrota që vihen në lëvizje vetëm në saje të veprimit të muskujve, nëpërmjet pedaleve ose sistemeve të ngjashme dhe që drejtohen nga njerëzit e hipur në to. Mjete me pedale konsiderohen dhe ato mjete të pajisura me motor elektrik, me fuqi deri në 0,25 kw, ku furnizimi me energji i të cilave zvogëlohet në mënyrë progresive dhe përfundimisht ndërpritet kur arrihet shpejtësia 25 km/h ose kur ndalohet pedalimi.
2. Mjetet me pedale nuk mund të tejkalojnë 1.30 m gjerësi, 3 m gjatësi dhe 2.20 m lartësi.”.

Neni 6

Fjalja e parë, e pikës 1, të nenit 52, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Ciklomotorët janë mjete me motor, me dy, tre ose katër rrota që kanë këto karakteristika:”

Neni 7

Pas pikës 2, të nenit 60, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Ciklomotorët dhe motomjetet e regjistruara në listën e qendrës historike të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor pas një periudhe gjashtëmujore, kur plotësojnë kërkesat e normave në fuqi për qarkullimin rrugor, mund të regjistrohen në regjistrin e mjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.”.

Neni 8

Në nenin 79 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 1 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Prodhuesit dhe përfaqësuesit e tyre t’i transmetojnë qendrave të kontrollit teknik informacion mbi sistemet dhe pajisjet e mjeteve për të cilat kryhet kontrolli teknik, në mënyrë të vazhdueshme, në kohë, pa kufizim, me qasje të lehtë dhe jodiskriminuese. Informacioni të vihet në dispozicion 6 muaj pas regjistrimit të mjetit.

Bëjnë përjashtim rastet e parashikuara në pikat 6 dhe 8, të këtij neni, për të cilat informacioni të transmetohet sipas kërkesës dhe pa vonesa.”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Të gjitha mjetet, që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontroll teknik. Për mjetet e reja me motor, kontrolli teknik do të kryhet brenda tre vjetëve nga data e regjistrimit të parë. Pas kësaj periudhe ky kontroll kryhet për çdo dy vjet. Mjetet e kategorisë M₁, të përdorura si taksi dhe ambulanca si dhe mjetet e kategorive M₂, M₃, N₂, N₃, O₃, dhe O₄ kryejnë kontroll teknik çdo vit. Mjetet e reja të kategorisë M₁, të përdorura si taksi dhe ambulanca si dhe mjetet e kategorive M₂, M₃, N₂, N₃, O₃, dhe O₄ kryejnë kontroll teknik brenda një viti nga data e regjistrimit të parë dhe më pas çdo vit.”.

3. Pika 4 shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 92 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pikat 5 dhe 8 shfuqizohen.
2. Pas pikës 6 shtohen pikat 6/1, 6/2 dhe 6/3, me këtë përmbajtje:

“6/1. Cilido, që qarkullon me një mjet për të cilin ka kaluar mbi 30 ditë afati i sigurimit të detyrueshëm, ndëshkohet me masë administrative me gjobë sipas parashikimeve të nenit 191, pika 2. Rregullat dhe procedurat për vendosjen e gjobës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6/2. Qendra e Informacionit, e krijuar sipas ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, njofton menjëherë organet e ngarkuara nga ligji për regjistrimin e mjeteve dhe ato të kontrollit të qarkullimit rrugor mbi mjetet e pasiguruara, për ekzekutimin e masave administrative të parashikuara në këtë nen dhe sigurimin e mjeteve pas marrjes së këtyre masave.

6/3. Cilido, që qarkullon me një mjet të blinduar, për të cilin mungon autorizimi i lëshuar nga organi kompetent, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga njëqind mijë deri në dyqind mijë lekë dhe zbatohet masa administrative plotësuese e konfiskimit të mjetit. Të njëjtat masa zbatohen ndaj zotëruesit të mjetit nëse ky i beson mjetin një drejtuesi të paautorizuar.”.

Neni 10

Pika 1, e nenit 93, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Në rast ndryshimi pronësie të mjeteve rrugore ose në rastin kur i jepen në përdorim të tjerëve a kur lidhen marrëveshje për qiradhënie me të drejtë blerjeje, personi i interesuar, brenda 30 ditëve nga data kur nënshkrimi i aktit është vërtetuar ose është gjykuar i rregullt, paraqitet pranë degës përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila merr masa për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë ose të ndryshimeve të tjera.”.

Neni 11

Në nenin 94 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet me këtë përmbajtje “Humbja, vjedhja ose shkatërrimi i lejes së qarkullimit”.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Zyra e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, pasi i është paraqitur vërtetimi i denoncimit të humbjes apo vjedhjes së lejes së qarkullimit dhe deklarata e marrjes së përgjegjësisë administrative, me kërkesë të zotëruesit të lejes së qarkullimit ose përmes një personi të autorizuar prej tij, lëshon një leje qarkullimi të re. Në mënyrë alternative, mund të kërkohej lëshimi i lejes së përkohshme të qarkullimit me afat vlefshmërie maksimale prej 30 ditësh.”.

3. Pika 3 shfuqizohet.

4. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Cilido, që qarkullon me një mjet, për të cilin nuk janë respektuar parashikimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, për rastet e humbjes, vjedhjes apo shkatërrimit të lejes së qarkullimit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë. Për këtë shkelje zbatohet edhe masa administrative plotësuese e ndalimit administrativ të mjetit.”.

Neni 12

Në nenin 101 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijo:

“2. Pasi të jetë bërë denoncimi i humbjes ose vjedhjes së targave, zotëruesi i lejes së qarkullimit ka të drejtë të kërkojë menjëherë pranë degës përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor një regjistrim të ri për mjetin, sipas procedurave të treguara në nenin 92.”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

3. Në pikën 6, fjalët “... ose qarkullon me tabelën e treguar në pikën 3...” hiqen.

Neni 13

Në pikën 3, të nenit 115/1, tre paragrafët e parë shfuqizohen.

Neni 14

Në fund të pikës 8, të nenit 119, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Afati i vlefshmërisë së provimit të njohurive teorike të fituara nga kandidati për lejedrejtimi është një vit nga momenti i marrjes së këtij provimi.”.

Neni 15

Pika 6, e nenit 120/1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Me humbjen totale të pikëve, mbajtësi i lejedrejtimit ndjek një kurs pranë autoshkollave të licencuara. Në përfundim të këtij kursi, drejtuesi i mjetit i nënshtrohet provimit të kualifikimit teknik, sipas nenit 128 të këtij Kodi dhe akteve të tjera në fuqi. Procedurat për ndjekjen e kursit pëcaktohen në aktet në zbatim.”.

Neni 16

Pas pikës 8, të nenit 121, shtohet pika 9, me këtë përmbajtje:

“9. Cilido, që financon, prodhon, shpërndan, mban për qëllime tregtimi, ofron për shitje ose përdor materiale didaktike për sigurinë rrugore dhe aftësimin e njohurive teorike e praktike të kandidatit për lejedrejtimi, manuale teorike, udhëzues teorik ose broshura sensibilizuese, të cilat janë të destinuara për përdorim në autoshkolla dhe janë të pamiratuara nga ministria përgjegjëse për transportin, ndëshkohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor me masë administrative me gjobë nga pesëdhjetë mijë lekë deri në njëqind mijë lekë.”.

Neni 17

Në nenin 123 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli ndryshohet me këtë përmbajtje “Periudhat dhe njëvlefshmëritë midis kategorive të lejedrejtimit”.
2. Në pikën 1, pas shkronjës “b” shtohen shkronjat “c”, “ç” dhe “d”, me këtë përmbajtje:

“c) Për drejtimin e mjeteve, për të cilat kërkohet lejedrejtimi e kategorisë C1 ose D1, mund të aftësohen vetëm ata persona që janë të pajisur me

lejedrejtimi për të drejtuar mjete motorike, për të cilat kërkohet përkatësisht lejedrejtimi e kategorisë B ose C, e marrë prej 12 muajsh.

Për drejtimin e mjeteve, për të cilat kërkohet lejedrejtimi e kategorisë C1 ose C1E, mund të aftësohen vetëm ata persona që janë të pajisur me lejedrejtimi për të drejtuar mjete motorike, përkatësisht të kategorisë B ose C1, të marrë prej 12 muajsh;

- ç) Për drejtimin e mjeteve, për të cilat kërkohet lejedrejtimi e kategorisë C ose D, mund të aftësohen vetëm ata persona që janë të pajisur përkatësisht me lejedrejtimi të kategorisë B ose C, të marrë prej 3 vitesh.

Për drejtimin e mjeteve, për të cilat kërkohet lejedrejtimi e kategorisë D1 ose D1E, mund të aftësohen vetëm ata persona që janë të pajisur me lejedrejtimi për të drejtuar mjete motorike, përkatësisht të kategorisë B, të marrë prej 3 vjetësh ose D1 të marrë prej 12 muajsh. Mosha minimale për t'u pajisur me lejedrejtimi të kategorisë D1 dhe D1E është 21 vjeç.

Për drejtimin e mjeteve, për të cilat kërkohet lejedrejtimi e kategorisë D, mund të aftësohen vetëm ata persona që janë të pajisur me lejedrejtimi për të drejtuar mjete motorike, të kategorisë B, të marrë prej tre vitesh ose kategori D1 të marrë prej 12 muajsh. Mosha minimale për t'u pajisur me lejedrejtimi të kategorisë D është 24 vjeç;

- d) Për drejtimin e automjeteve, për të cilat kërkohet lejedrejtimi e kategorive BE, C1E, CE, D1E dhe DE, mund të aftësohen vetëm ata persona që janë të aftësuar për të drejtuar mjete, për të cilat kërkohet lejedrejtimi përkatësisht e kategorive B, C1, C, D1 dhe D, e marrë prej 12 muajsh.”.

Neni 18

Në nenin 124 bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në pikën 3, shprehja “60 vjeç” zëvendësohet me “65 vjeç.”.
2. Në pikën 11, fjalët “deri në dyzet mijë lekë” zëvendësohen me “deri në pesëmbëdhjetë mijë lekë”.

Neni 19

Në nenin 125 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli ndryshohet me këtë përmbajtje: “Humbja, vjedhja ose shkatërrimi i lejedrejtimit”.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Pasi të jetë bërë denoncimi i humbjes ose vjedhjes së lejedrejtimit, zotëruesi i saj ka të drejtë të kërkojë menjëherë pranë degës përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor lëshimin e dublikatit ose të pajiset me një lejedrejtimi të re. Në mënyrë alternative, me kërkesë të zotëruesit të lejedrejtimit, dega përkatëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor lëshon një dokument të përkohshëm drejtimi mjeti me afat maksimal 30 ditë.”.

3. Pika 4 shfuqizohet.

Neni 20

Pika 5, e nenit 130, ndryshohet, si më poshtë vijo:

“5. Cilido, që shkel dispozitat e pikës 1, ndëshkohet me masën administrative plotësuese të konfiskimit të mjetit.”.

Neni 20/1

Pas shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 136, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) për realizimin e detyrave operacionale të FA-së, Ministria e Mbrojtjes i kërkon ministrisë që mbulon veprimtarinë përkatëse, për personelin në shërbim dhe të përgatitur nga strukturat përgjegjëse të FA-së testimin dhe pajisjen me leje drejtimi kombëtare ose të veçantë shërbimi nga strukturat e saj, sipas rregullave në fuqi.”.

Neni 21

Neni 137 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 137 Certifikatë profesionale policore

1. Personeli, që është i pajisur me lejedrejtimi dhe kryen shërbimin e policisë rrugore, policisë së rendit, policisë kriminale, policisë së burgjeve dhe policisë bashkiake, për drejtimin e mjeteve të regjistruara vetëm për një përdorim të tillë duhet të pajiset me një certifikatë profesionale policore, që tregon emrin dhe adresën e mbajtësit, të gjitha të dhënat e nevojshme për identifikimin e tij, kualifikimin dhe institucionin, agjencinë apo strukturën nga e cila varet.

2. Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike merr masa në mënyrë të drejtpërdrejtë në lidhje me pajisjen me certifikatë profesionale policore.
3. Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike merr masa në mënyrë të drejtpërdrejtë në lidhje me formimin dhe trajnimin e personelit në drejtimin e mjeteve të shërbimit:
 - a) Për trajnimin dhe verifikimin e aftësive të nevojshme për drejtimin e mjeteve, provimin e aftësisë për lëshimin e certifikatës profesionale policore, që vlen vetëm për drejtuesit e mjeteve që i përkasin ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike apo institucioneve të saj të varësisë;
 - b) Për lëshimin e certifikatës profesionale policore për drejtimin e mjeteve të shërbimit organizohen kurse teorike e praktike me afate të caktuara. Kohëzgjatja e kurseve dhe mënyra e marrjes në prova përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike;
 - c) Certifikatat profesionale policore për drejtimin e mjeteve të shërbimit lëshohen mbi bazën e lejedrejttimeve ekzistuese që ka çdo drejtues mjeti, të lëshuara nga ministria që mbulon veprimtarinë përkatëse të transportit.
4. Kushdo drejtues mjeti që drejton një mjet të sistemit të policive të përmendura në këtë nen, i pajisur me lejedrejtimi përkatëse, por i papajisur me certifikatën profesionale policore, ndëshkohet me gjobë nga dy mijë e pesëqind lekë deri në dhjetë mijë lekë.”.

Neni 22

Në nenin 140 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pikat 6, 7, 8 dhe 9 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“6. Për përcaktimin e respektimit të kufijve të shpejtësisë, rezultatet e sistemeve të miratuara konsiderohen burime prove për llogaritjen e shpejtësisë mesatare të qarkullimit të automjeteve dhe në seksione të caktuara rrugore. Konsiderohen gjithashtu prova regjistrimet e tahogرافit, si dhe dokumentet përkatëse të kalimit në autostradë. Stacionet/pikat e kontrollit në rrjetin rrugor për identifikimin e tejkalimit të shpejtësisë, duhet të jenë më parë të shënuara dhe qartësisht të dukshme, duke përdorur shenjat/tabelat vertikale dhe horizontale, ose nëpërmjet pajisjeve sinjalizuese të ndritshme, në përputhje me rregullat e përcaktuara në aktet në zbatim.

7. Kushdo, që tejkalon kufijtë minimalë dhe maksimalë të shpejtësisë me jo më shumë se 10 km/orë, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga një mijë deri në tre mijë lekë.

8. Kushdo, që tejkalon kufijtë maksimalë të shpejtësisë me më shumë se 10 km/orë dhe jo më shumë se 30 km/orë, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga dy mijë deri në katër mijë lekë.

9. Kushdo, që tejkalon kufijtë maksimalë të shpejtësisë me më shumë se 30 km/orë por jo më shumë se 50 km/orë jashtë qendrave të banuara dhe më shumë se 20 km/orë, por jo më shumë se 40 km/orë në qendrat e banuara, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga pesë mijë deri në pesëmbëdhjetë mijë lekë. Si pasojë e kësaj shkeljeje, aplikohet edhe masa administrative plotësuese e pezullimit të lejes së drejtimit nga një deri në tre muaj, si dhe e heqjes së pikëve sipas përcaktimeve të bëra në aktet në zbatim.”.

2. Pas pikës 9 shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

“9/1. Kushdo, që tejkalon kufijtë maksimalë të shpejtësisë për më shumë se 50 km/orë jashtë qendrave të banuara dhe më shumë se 40 km/orë në qendrat e banuara, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga dhjetë mijë lekë deri në njëzet mijë lekë. Si pasojë e kësaj shkeljeje, aplikohet masa administrative plotësuese e pezullimit të lejes së drejtimit nga 3 (tre) deri në 6 (gjashtë) muaj si dhe heqja e pikëve, sipas përcaktimeve të bëra në aktet në zbatim.”.

3. Pikat 10, 11 dhe 12 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“10. Kushdo, që shkel dispozitat e përmendura në pikën 4, të këtij neni, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga 20 mijë deri në 40 mijë lekë.

11. Nëse shkeljet e përmendura në pikat 7, 8, 9 dhe 9/1 janë kryer gjatë drejtimit të automjeteve, treguar në pikën 3, shkronjat “b”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i” dhe “l”, gjobat dhe masat plotësuese dyfishohen. Tejkalimi i shpejtësisë përtej kufirit në të cilën është kalibruar kufiri i shpejtësisë, i përmendur në këtë nen, nënkupton aplikimin e masave administrative të parashikuara në pikat 2/1 dhe 3, të të njëjtit nen, në automjetet që kërkohen për të montuar këtë pajisje.

12. Kur zotëruesi i lejedrejtimit, në një periudhë dyvjeçare, ka kryer shkelje të mëtejshme të pikave 9 dhe 9/1, lejedrejtimi pezullohet nga tetë deri në tetëmbëdhjetë muaj.”.

Neni 23

Në nenin 143 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 5, të nenit 143, pas fjalës “ndalojnë” shtohet “... me qëndrim të plotë, deri në arritjen në shpejtësinë 0 (zero) ...”.
2. Në pikën 10, fjalët “... nga një mijë deri në tre mijë lekë ...” zëvendësohen me fjalët “... nga pesë mijë deri në tetë mijë lekë ...”.
3. Në fund të pikës 11 shtohen fjalët “... dhe i hiqen pikët sipas përcaktimeve të bëra në aktet në zbatim ...”.
4. Pas pikës 11 shtohet pika 12, me këtë përmbajtje:

“12. Në rast të verifikimit të një aksidenti me dëme materiale ku është identifikuar si shkelje mosrespektimi i përparësisë, për këtë shkelje drejtuesi i mjetit fajtor ndëshkohet përveç masës administrative me gjobë sipas pikës 10 dhe me heqjen e pikëve sipas përcaktimeve të bëra në aktet në zbatim.”.

Neni 24

Në nenin 146 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“16. Kushdo, që nuk zbaton ndalimet e parakalimit, sipas pikave 9, 10, 11, 12 dhe 13, të këtij neni, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga pesë mijë deri në dhjetë mijë lekë. Kur nuk zbatohen ndalimet e parakalimit, sipas pikës 14 të këtij neni, masa administrative është me gjobë nga dy mijë deri në gjashtë mijë lekë. Kushdo, që konstatohet me këtë shkelje dy herë brenda të njëjtut vit, ndëshkohet me dyfishin e masës së parashikuar në këtë pikë dhe i pezullohet leja e drejtimit për një muaj.”.

2. Pas pikës 16 shtohet pika 17, me këtë përmbajtje:

“17. Në rast të verifikimit të një aksidenti me dëme materiale ku është identifikuar si shkelje parakalimi i gabuar, drejtuesi i mjetit fajtor për këtë shkelje ndëshkohet përveç masës administrative me gjobë sipas pikës 16, të këtij neni, edhe me heqjen e pikëve sipas përcaktimeve të bëra në aktet në zbatim.”.

Neni 25

Në nenin 155 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 5 shtohen fjalët "... përjashtim bëjnë mjetet autoveturë, gjatësia e të cilave nuk e kalon kuadratin e sinjalizuar për parkim të entit pronar të rrugëve ...".
2. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. Cilido, që shkel dispozitat e këtij neni, 3 herë brenda një viti si dhe kushdo që parkon në mënyrë abuzive në vendet e përcaktuara në hapësirat e rezervuara për personat me aftësi të kufizuar ose parkon në trotuar, përveç masës administrative me gjobë, i hiqen edhe pikë nga leja e drejtimit."

Neni 26

Në nenin 169 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2, fjalët "... nga pesëqind deri në një mijë e pesëqind lekë ..." zëvendësohen me fjalët "... nga një mijë deri në tre mijë lekë ...".
2. Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

"5. Drejtuesi i motomjeteve është i detyruar të bëhet i dallueshëm në trafik në kushtet e errësirës duke mbajtur një jelek fosforeshent të homologuar. Kushdo që nuk zbaton këtë detyrim ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga një mijë deri tre mijë lekë."

Neni 27

Në fund të pikës 8, të nenit 170, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Drejtuesi i mjetit ndëshkohet me masë administrative me gjobë, nga një mijë deri në tre mijë lekë, nëse konstatohet se në mjetin që ai drejton ka pasagjerë që nuk kanë vendosur rripin e sigurimit."

Neni 28

Në nenin 171 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Është e ndaluar që drejtuesi i mjetit të përdorë gjatë lëvizjes mjete

teknologjike të komunikimit dhe ndërveprimit, si aparatura radiotelefonike apo celulare, kufje zanore, me përjashtim të drejtuesve të mjeteve të Forcave të Armatosura dhe të policisë. Përdorimi i pajisjeve pa kufje ose me kufje lejohet për sa kohë që drejtuesi i mjetit ka aftësi të përshtatshme dëgjimi në të dy veshët, të cilat nuk kërkojnë përdorimin e duarve për funksionimin e tyre.”.

2. Në pikën 3, fjalët “... nga pesëqind deri në një mijë e pesëqind lekë ...” zëvendësohen me fjalët “... nga pesë mijë deri në pesëmbëdhjetë mijë lekë ...”.
3. Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Në raste të përsëritjes së shkeljes së përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, 3 herë brenda të njëjtit vit, drejtuesit të mjetit i pezullohet leja e drejtimit 3 muaj dhe i hiqen pikë sipas përcaktimeve të bëra në aktet në zbatim.”.

Neni 29

Në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 173, fjala “150 cc” zëvendësohet me “49 cc”.

Neni 30

Në nenin 184 bëhen këto ndryshime she shtesa:

1. Pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Ndalohet drejtimi i mjetit pas përdorimit të pijeve alkoolike.

2. Kushdo që drejton mjetin nën ndikimin e alkoolit ndëshkohet:

- a) me masë administrative, gjobë në masën prej pesë mijë deri në pesëmbëdhjetë mijë lekë, nëse është konstatuar një vlerë që korrespondon me një përmbajtje alkoolike deri në 0,3 gram për litër (g/l). Përjashtim bëjnë drejtuesit e mjeteve që kanë më pak se tre vjet vjetërsi lej drejtimit, si dhe drejtuesit e mjeteve me peshëmbajtje mbi 3,5 tonë, të mjeteve taksi dhe të shërbimit të transportit publik, për të cilët përveç masës së parashikuar me gjobë iu pezullohet leja e drejtimit nga 3 muaj deri në 6 muaj;
- b) me masën administrative gjobë nga dhjetë mijë deri në njëzet mijë lekë, nëse është konstatuar një vlerë që korrespondon me një

përmbajtje alkoolike më të lartë se 0.3 gram për litër dhe jo më të lartë se 0.5 gram për litër (g/l). Konstatimi i shkeljes shoqërohet me masën administrative shtesë të pezullimit të lejes së drejtimit nga tre deri në gjashtë muaj;

- c) me masë administrative me gjobë nga dhjetë mijë lekë deri në njëzet mijë mijë lekë dhe me pezullim të lejedrejtimit nga 12 muaj deri në 24 muaj, nëse është konstatuar një vlerë që korrespondon me një përmbajtje alkooli nga 0,5 deri 0.8 gram për litër (g/l);
 - ç) me masë administrative me gjobë nga njëzet mijë lekë deri në dyzet mijë lekë dhe me pezullim të lejedrejtimit nga 12 muaj deri në 24 muaj, nëse është konstatuar një vlerë që korrespondon me një përmbajtje alkooli më të lartë se 0.8 dhe deri në 1.5 gram për litër(g/l);
 - d) në çdo rast, masa administrative me gjobë dhe ajo plotësuese e pezullimit të lejes së drejtimit, për rastet e konstatimit të drejtuesit të mjetit në gjendje të dehur me përdorim alkooli në vlerën mbi 0,5 g/litër i vendosur nga organi i Policisë Rrugore, i dërgohet zyrtarisht organit hetimor që ka filluar procedimin penal;
 - dh) në të gjitha rastet e konstatimit të drejtuesit të mjetit nën ndikimin e alkoolit, përveç masës administrative me gjobë, sanksionit plotësues të pezullimit të lejedrejtimit sipas paragrafëve të mësipërm, bëhet edhe heqja e pikëve. Nëse shkelja përsëritet brenda vitit bëhet heqja e sasisë së pikëve të lejedrejtimit sipas përcaktimeve në aktin në zbatim.
3. Nëse drejtuesi i mjetit në gjendje të dehur shkakton një aksident rrugor me pasojë dëme materiale, përveç masave administrative sipas përqindjes së alkoolit të evidentuar, bëhet edhe ndalimi administrativ i automjetit për dy muaj, përveç rasteve kur automjeti i përket një personi që nuk ka lidhje me veprën penale.
4. Nëse për drejtuesin e mjetit, që shkakton një aksident rrugor, është evidentuar një vlerë që korrespondon me një përmbajtje alkooli më të lartë se 1.5 gram për litër (g/l), duke respektuar dhe plotësuar dispozitat përkatëse në këtë nen, lejedrejtimi i hiqet.
5. Kur mjete nuk mund të drejtohet nga një njeri tjetër i përshtatshëm, mund të tërhiqet deri në vendin e treguar nga i interesuari ose në ofiçinën më të afërt dhe lihet nën kujdesin e pronarit ose të administratorit me garancitë normale për ruajtjen e mjetit. Kostot e rimëkëmbjes dhe transportit përballohen plotësisht nga kundërvajtësi.
6. Masa administrative e parashikuar rritet nga një e treta deri në dy të tretat kur shkelja është kryer pas orës 22:00 deri në orën 07:00 të mëngjesit.”.

2. Pas pikës 11 shtohen pikat 12 dhe 13, me këtë përmbajtje:

“12. Duke konsideruar bashkëshoqërimin e veprës penale me shkeljen administrative, parashikuar në dispozitat e këtij kodi, në çdo rast të evidentimit të drejtuesve të mjeteve në gjendje të dehur, organi i policisë rrugore procedon administrativisht, duke zbatuar dispozitat e mësipërme.

13. Në zbatim të afateve të kodit rrugor vendimet e policisë, masat dhe pezullimi i lejedrejtimit i dërgohen organit procedues të prokurorisë.”.

Neni 31

Neni 187 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 187

1. Përdoruesi i rrugës, në rast aksidenti, që në çdo rast lidhet me sjelljen e tij, ka detyrimin të ndalojë dhe të sigurojë ndihmën e nevojshme për ata që kanë pësuar dëme për personat e përfshirë.
2. Personat e përfshirë në një aksident duhet të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të mbrojtur sigurinë e trafikut dhe, në përputhje me këtë kërkesë, të marrin masa për të siguruar që gjendja e provave dhe gjurmët e dobishme për konstatimin e përgjegjësive të pjesëmarrësve të mos ndryshohen.
3. Nëse nga aksidenti ka vetëm dëmtime materiale të pronës, drejtuesit e mjeteve dhe çdo përdorues tjetër i rrugës i përfshirë gjithashtu në aksident, kur është e mundur, duhet të shmangin pengesat në trafik, në përputhje me parashikimet e këtij kodi. Agjentët në shërbimin e policisë rrugore, në raste të tilla, urdhërojnë heqjen e menjëhershme të çdo pengese për trafik, përveç ekzekutimit me urgjencë të çdo prove të nevojshme për të konstatuar rrethanat dhe dinamikën e aksidentit.
4. Drejtuesi i mjetit që ka kryer aksidentin, pasi të ketë përcaktuar vendin e ngjarjes, kur nuk ka mjete të tjera për të dërguar të aksidentuarit në qendrën më të afërt të mjekimit, i transporton ata dhe kthehet menjëherë në vendin e ngjarjes, kur ai është në gjendje t'i kryejë këto veprime. Në çdo rast, drejtuesit e mjeteve, gjithashtu, duhet të sigurojnë detajet dhe të dhënat e tyre personale, si dhe informacione të tjera të dobishme, gjithashtu për qëllime kompensimi për personat e dëmtuar ose, nëse nuk janë të pranishëm, t'u komunikojnë atyre në mënyrat e mundshme elementet e mësipërme.

5. Aty ku, si pasojë e ngjarjes rrugore, janë shkaktuar vetëm dëme materiale, drejtuesit e mjetit dhe çdo përdorues tjetër i rrugës i përfshirë në aksident duhet, gjithashtu, të shmangin pengimin e qarkullimit, aty ku është e mundur, sipas dispozitave të nenit 159 dhe të njoftojnë kur është e mundur shoqërinë/shoqëritë përkatëse të sigurimit. Palët hartojnë procesverbalin përkatës të ngjarjes (raportin miqësor për ngjarjen), sipas ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit dhe ia paraqesin për veprime të mëtejshme shoqërisë/shoqërive të sigurimit.
6. Aty ky, si pasojë e ngjarjes rrugore, janë shkaktuar vetëm dëme materiale në mjetin/mjetet motorike dhe palët e përfshira nuk bien dakord për një raport “miqësor” mbi ngjarjen, drejtuesit e mjetit dhe çdo përdorues tjetër i përfshirë në aksident duhet të njoftojnë organet e Policisë së Shtetit dhe me tej shoqërinë/shoqëritë përkatëse të sigurimit për kryerjen e veprimeve dhe administrimin e dokumentuar të ngjarjes rrugore.
7. Aty ku, si pasojë e ngjarjes rrugore, janë shkaktuar edhe dëmtime të rrugës dhe elementeve përbërëse të saj, si dhe dëme të tjera pasurore (përveç dëmeve në mjetin/mjetet rrugore), drejtuesit e mjetit dhe çdo përdorues tjetër i rrugës i përfshirë në aksident, në çdo rast, njoftojnë organet e Policisë së Shtetit dhe shoqërinë/shoqëritë përkatëse të sigurimit për kryerjen e veprimeve dhe administrimin e dokumentuar të ngjarjes rrugore.
8. Kushdo që, në kushtet e përmendura në pikat 5, 6 dhe 7, të këtij neni, nuk respekton detyrimin për të ndaluar në rast aksidenti, me dëmtim vetëm të pasurisë ose të dëmtimit të personave, kur nuk përbën vepër penale i nënshtrohet masës administrative të pagimit të një shume nga dhjetë mijë mijë deri në pesëmbëdhjetë mijë lekë, si dhe të heqjes së sasisë së pikëve të përcaktuara në aktet në zbatim.”.

Neni 32

Në fund të pikës 8, të nenit 188, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në karrexhatat e rrugëve lejohet qarkullimi i patinave elektrike për të cilat zbatohen rregullat e nenit 180, të këtij Kodi.”.

Neni 33

Pika 2, e nenit 189, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Në qendrat e banuara, të papajisura me vendkalime këmbësorësh,

drejtuesit e mjeteve duhet t'i lejojnë këmbësorit që ka filluar kapërcimin e karrexhatës, të arrijë i sigurt në anën tjetër. Për këmbësorët që konstatohet ecje e pasigurt, drejtuesi i automjetit duhet të shmangë situata të rrezikshme që mund sjellin aksidente duke ndaluar deri në krijimin e sigurisë se nuk përbën rrezik për këmbësorin.”.

Neni 34

Në fund të nenit 192 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Për një kategori shkeljesh rrugore, për të cilat nuk ka sanksion plotësues dhe janë nën vlerën 5 000 lekë, për të cilat agjenti verifikues vendos të këshillojë kundërvajtësin, këshillimi duhet të administrohet në sistemet e policisë. Për drejtuesin e mjetit të këshilluar dhe evidentuar në sistem, nëse konstatohet me të njëjtën shkelje brenda një viti, vendoset masa maksimale e parashikuar nga dispozita e shkelur.”.

Neni 35

Në fund të pikës 3, të nenit 199, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Njoftimi i shkeljeve dhe i vendimeve, që merren nga organet e përcaktuara në dispozitat e këtij kodi, i dërgohen kundërvajtësve edhe me njoftim elektronik të certifikuar.”.

Neni 36

Neni 201 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 201

Kundërvajtjet sipas këtij kodi shqyrtohen vetëm në bazë të ankesës së shtetasve kundërvajtës, nga organi administrativ shtetëror në territorin e të cilit është efektiv agjenti verifikues, ose në organin administrativ ku ka adresën e banimit kundërvajtësi, organe të cilat marrin vendimin përkatës.”.

Neni 37

Pika 6, e nenit 212, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Kushdo që, gjatë periudhës kur është tërhequr dokumenti, qarkullon në mënyrë abuzive me të njëjtin mjet, të cilit i referohet tërheqja e dokumentit, dënohet me gjobë nga dhjetë mijë deri në dyzet mijë lekë dhe

ndaj tij zbatohet edhe masa administrative plotësuese e heqjes së lejedrejtimit.”.

Neni 38

Në fund të nenit 217 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Organi administrativ i policisë, për shkelje që parashikohen edhe si kundërvajtje administrative, plotëson procedurat e kërkuara nga Kodi Rrugor dhe për vendimet që merr, njofton brenda afateve të këtij kodi organin procedues të Prokurorisë dhe të Gjykatës, sipas rastit. Kjo e fundit pasi ka administruar në fashikull edhe procedimin administrativ në vendimin përfundimtar, evidenton sa më sipër.”.

Neni 39

Shkronja “b”, e pikës 2, të nenit 223, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) për kryerjen apo nxitjen e pjesëmarrjes në kurse të kualifikimit, azhurnimit ose të specializimit pasuniversitar të personelit, në lidhje me zbatimin e këtij Kodi, si dhe për zhvillimin e programeve të sigurisë rrugore.”.

Neni 40

Kudo në përmbajtjen e ligjit, shprehja “kontrolli teknik vjetor dhe periodik” zëvendësohet me shprehjen “kontrolli teknik”, fjala “biçikletë” zëvendësohet me shprehjen “mjet me pedal”.

Neni 41

Dispozita kalimtare

Certifikatave të kontrollit teknik, që janë të vlefshme në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, iu zgjatet afati i vlefshmërisë sipas afateve të reja, të parashikuara në këtë ligj.

Neni 42

Aktet nënligjore

Ngarkohet ministri përgjegjës për transportin që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 79, pika 1, të Kodit Rrugor.

Neni 43

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI